

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Fatmire Sërmagjaj, në lëndën penale ndaj të pandehurit R. S. nga Gj, për shkak të dy veprave penale vjedhje nga neni 252 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sipas aktakuzës (propozimakuze) së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.nr.473/12 të dt.30.03.2012, si dhe veprës penale në bashkëkryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 02.02.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri R. S, nga babai O. dhe nana H,e lindur S, i lindur më, në fsh.V e Zh, Komuna e Gj,e tani jeton në Gjilan, rruga "..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babe I . femijve, veteran i luftës së UQK-së, i gjendjes së varfer ekonomike, më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale,

Është fajtor

I.

Sepse me datë 10.03.2012, rreth orës 20.30 minuta, në oborrin e Fabrikës së Radiatorave në Gjilan,me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, i pandehuri R.S, ka vjedhur në Fabrikën e Radiatorave ne Gj, në at mënyrë që nga ana e epërme e fabrikës, depërton brenda në oborr dhe nga një kontejner vjedh një sasi të mbeturinave të metalta prej bakuri, dhe të njëjtat

*-me këtë ka kryer vepër penale **vjedhje**, nga neni 252 paragrafi 1 të KPK-së dhe*

II.

Me datë 21.08.2013, rreth orës 03.30 minuta, në Gjilan, në afërsi të tunelit në rrugë të Prishtinës, përderi sa i dëmtuari A. H., ishte me automjetin e llojit "... me dy pasagjerët L. A dhe T. V, me të arritur te tuneli në hyrje të Gjilanit nga

drejtimi i Prishtinës, të pandehurit R. S dhe H.S me veturë i kishin dalë përpara, kështu që i njëjti edhe kishte qenë i detyruar që të ndalet, e më pas nga ajo veturë kishin dalur dy të pandehurit, dhe tani të dëmtuarin e kishin goditur disa herë me grushta në fytyrë, me që rast si pasojë e goditjeve, të njëjtit i janë thyer edhe dhëmbët e prërm,të cilët i kishte vendosur me protezë, e për shkak të të cilave lëndime, i dëmtuari A, ka qenë i detyruar që të kërkoj ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, sipas raportit mjekësor të dt.21.08.2013.

Me qka në bashkëkryerj e ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 3,6,11,15,41,42,43 dhe 64 të KPK,si dhe të neneve 4,7,17,21,49,50,51,52,73 dhe 80 të KPRK-së,si dhe nenevet 365,451 e 463 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit R. S, i caktohet dënimi për veprën nën dispozitivin e parë me burgim ne kohëzgjatje prej 100(njëqind) ditëve,e për veprën penale nën dispozitivin e II-të dënimi me burgim prej 180 (njqindetëtdhjetë) ditëve , e konform nenit 80 të KPRK-së, atij i shqiptohet një dënim unik në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, të cilin pandehuri nuk do ta vuajë, nëse në afat prej 2 (dy) viteve nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit Përfaqsesi i Fabrikës së Radiatorëve në Gjilan dhe A.H, për realizimin e kërkesave pasurore-juridike, udhëzohen në kontestin civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzat PP.nr.473/12 dhe 1852-a/2013 ndaj të pandehurve R. S e H. S që të dy nga Gj, për shkak të veprave penale vjedhje, nga neni 252 paragrafi 1 të KPK-së si dhe lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Procedura penale është veqar ndaj të akuzuarit të dytë H. S, i cili për momentin jeton në Zvicër dhe thuhet se atje është në vuajtje të një dënimi.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri R. S, ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi të dy aktakuzat dhe veprat penale për të cilat akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e këtyre dy veprave penale të cilat më vihen në barrë sipas këtyre dy aktakuzave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit edhe të prokurorit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmbajnë aktakuzat, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuzat nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri R.S. me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer veprën penale vjedhje, nga neni 252 paragrafi 1 i KPK,si dhe ate të lëndimit të lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendet dhe mënyrat e përshkruara në dy dispozitivat e këtij aktgjykimi.

Gjykata, e shpalli fajtor të pandehurin R. S, për shkak të dy veprave penale vjedhje, nga neni 252 paragrafi 1 i KPK,dhe ate lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre dy veprave penale dhe se për të njejtat është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit R.S, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 64 të KPK-se gjegjësisht 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë; sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor; se ka shprehur keqardhjen për kryerjen e këtyre dy veprave penale; se i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale dhe se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale,i moshes se shtyer,veteran i UQK-së, baba i shtatë fëmijve, ndërsa nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese, pos dëmit të shkaktuar të dëmtuarve.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 i KPK-së dhe 50 të KPRK.

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 463të KPP, palët e dëmtuara i udhëzoi në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Më 02.02.2017

***Sekretarja juridike,
Fatmire Sermagjaj***

***Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi***

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*